



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Sinjal" Sh.P.K. të datës 10.06.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 07.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sinjalizimi horizontal dhe vertikal Llot IV" me nr. të prokurimit 616-22-11147-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 66 22 170 211, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Sinjal" Sh.P.K. e datës 10.06.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 07.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sinjalizimi horizontal dhe vertikal Llot IV" me nr. të prokurimit 616-22-11147-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 66 22 170 211.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatorit ekonomik "Sinjal" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-qov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "Sinjal" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 10.06.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 07.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sinjalizimi horizontal dhe vertikal Llot IV" me nr. të prokurimit 616-22-11147-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 66 22 170 211. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

**Pretendimi i parë (I):** "Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtines, ka publikuar Letren Standarde me te cilen shperblen me kontrate nje Operator tjetër Ekonomik, edhe pse Sinjal shpk ka qene me oferten me te ulet, konsiderojme qe jane bere shkelje te Ligjit te Prokurimit".

**Pretendimi i dytë (II):** "Sinjal shpk me rastin e dorezimit te ofertes ka dorezuar Listen e Kontratave me te gjitha referencat e bashkangjitura, mirepo i vetmi ndryshim eshte qe ne dokument nuk shkruan "Aneksi 6" por "Lista e Kontratave", gje qe verteton se te gjitha dokumentet dhe referencat jane bashkangjitur konform kerkesave te AK".

**Pretendimi i tretë (III):** "Sinjal shpk me rastin e dorezimit te ofertes ka dorezuar Atestet ne gjuhen italiane, gjuhe e cila nuk eshte zyrtare, mirepo edhe ne kete rast, konform Ligjit per Prokurim Publik 04/L-042 Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtese Autoriteti kontraktues mund te ftoje operatoret ekonomik per te plotesuar apo te qartesoje certifikatat dhe dokumentet e paraqitura ne pajtim me nenet 65-71 te ketij ligji. AK do te duhej te kerkonte Atestet ne njeren prej gjuheve zyrtare dhe ne do ti ofronim nje dokument te tille".

**Pretendimi i katërt (IV):** "Sinjal shpk ka kerkuar qasje ne dokumente te OE, dhe kemi konstatuar qe eshte Grupi i Operatoreve Ekonomik Fitues "Traffiks VA" shpk; "VIA" shpk; "Eurokos K=Holding" shpk dega ne Shqiperi, Dokumentin Certificate EN-1436 e ka dorezuar ne gjuhen gjermane (gjuhe jo zyrtare) dhe nen kriteret e njejta me te cilat Sinjal shpk eshte diskualifikuar".

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 dhe 72 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje "LPP").

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 19.06.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

**Lidhur me pretendimin e parë (I):** fillimisht duhet cekur që bazuar në dosjen e tenderit, kriteri i dhënies (neni 30.1) ka qenë "Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët".

Kriteret e Dhënies	30.1	Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët <input checked="" type="checkbox"/>
--------------------	------	---

Në rastin konkret parashtruesi është eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm. Rrjedhimisht nuk është aspak relevante sa është çmimi me të cilin kanë mundur të ofertojnë tenderuesit e papërgjegjshëm pasi që kriteri i dhënies është vetëm çmimi që ofertohet nga tenderuesit e përgjegjshëm. Prandaj ky pretendim i parashtruesit është i pabazuar në tërësi.

**Lidhur me pretendimin e dytë (II):** vlen të theksohet që komisioni i rivlerësimit është i përbërë nga tre (3) anëtarë kompetent, profesional, objektiv dhe tërësisht të pavarur. Ky fakt nuk kontestohet as nga vet parashtruesi në kërkesën e tij për rishqyrtim. Sidoqoftë,

Faqe 2 nga 5

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: [visar.shehu@rks-gov.net](mailto:visar.shehu@rks-gov.net)

komisioni për rivlerësim pikërisht në këtë përbërje ka bërë ekzaminimin, krahasimin dhe rivlerësimin e tenderëve në këtë aktivitet të prokurimit. Sa i përket ofertës së parashtruesit, komisioni ka gjetur që i njëjti duhet eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm në rastin konkret. Njëra nga arsyet për këtë i referohet faktit që parashtruesi nuk ka plotësuar aneksin 6 të dosjes së tenderit në formën dhe përmbajtjen sikurse është kërkuar me DT dhe FDT. Fakti që parashtruesi nuk e ka plotësuar siç duhet aneksin 6 të DT sipas formularit standard nuk kontestohet as nga vet parashtruesi pasi që ai në pretendimin e tij e pranon që nuk e ka përmbushur këtë kriter sipas DT (përkundër faktit që mundohet t'a relativizoj si çështje, njëkohësisht e pranon si fakt). Sa i përket pjesës së pretendimit ku parashtruesi aludon se kjo e gjetur është dashur të tolerohet nga komisioni duke kërkuar informata sqaruese, duhet cekur se për komisionin lidhur me çështjen konkrete nuk ka pasur diçka të paqartë për çka është dashur të kërkohej informata sqaruese. Me fjalë të tjera gjendja faktike ka qenë e pakontestueshme për të gjithë anëtarët e komisionit. Kjo gjendje faktike si e tillë nuk mund të ndryshohet aq më pak përmes informacioneve sqaruese sikurse pretendon parashtruesi. Në cilindo rast duhet pasur parasysh që kjo nuk ka qenë arsyeja e vetme për eliminimin e parashtruesit si tenderues të papërgjegjshëm. Prandaj nga cilido kënd i vështrimit rezulton se ky pretendim i parashtruesit është i pabazuar në tërësi.

**Lidhur me pretendimin e tretë (III):** LPP përmes nenit 13 par. 4 ka përcaktuar si në vijim *"Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze"*. Në rastin konkret nuk është fare kontestuese që parashtruesi ka dorëzuar një dokument që është kërkuar me DT (Atestet) në gjuhën italiane. Lidhur me një situatë të tillë, KRPP ka publikuar edhe opinionin nr. 7 të datës 22.11.2022 **"7. 22.11.2022 A duhet të refuzohet tenderi apo të kërkohej sqarime sipas 72, i cili ka sjellë dokumente në gjuhë tjetër nga ato të lejuara me LPP?"** si në vijim:

*"1) neni 13.4 nuk lejon asnjë përjashtim nga gjuhët e përmendura. As format standarde të cilat imponojnë AK për të miratuar të gjitha ose disa nga gjuhët e përcaktuara në nenin 13.4. Përveç kësaj, duhet të ceket se LPP-ja, përveç gjuhës shqipe dhe serbe, tashmë e lejon përdorimin edhe të Gjuhës Angleze. Zgjedhja e ligjvënësit është bërë në faktin se, duke qenë Gjuha Shqipe dhe Serbe jo shumë e përhapur, Gjuha Angleze lejon pjesëmarrjen e Operatoreve të huaj Ekonomik, pasi që është gjuha që përdoret ndërkombëtarisht;*

*2) në rastin e përmendur, është menduar, se specifikimet teknike të produktit të ofruar nga OE në fjalë do të duhet të ishin në dispozicion, jo vetëm në gjuhën e tenderuesit, por edhe në gjuhën angleze. Sipas përvojës, në fakt, specifikimet teknike të çdo produkti që ka relevancë ndërkombëtare zakonisht janë në dispozicion në gjuhën angleze. Kur ato nuk janë në dispozicion, OE në fjalë duhet të ketë dorëzuar, në vend të specifikimeve teknike në gjuhën e tenderuesit, një përkthim të certifikuar në anglisht për specifikimet teknike. Pra, sjellja e OE që sjellë dokumente në gjuhë tjetër nga ato të lejuara me ligj, është neglizhencë dhe plotësisht e pavarur nga një dispozitë e veçantë në dokumentet e tenderit.*

*3) Dispozita e lartpërmendur e LPP-së e cila përcakton përdorimin e gjuhëve gjatë procedurave të tenderimit është e përshkruar në mënyrë që të vë komisionin vlerësues*

Page 3 nga 5

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: [visar.shebu@rks-gov.net](mailto:visar.shebu@rks-gov.net)

*në pozitë më të mirë për të vlerësuar përmbajtjen e tenderit. Në parim, prodhimi i dokumenteve i cili nuk është i shoqëruar me një përkthim zyrtar është ekuivalente me mos-prodhim të të njëjtit, pasi që pengon autoritetin kontraktues që të ketë njohuri të menjëhershme dhe të drejtpërdrejtë për elementet përkatëse të tenderit.*

*4) parimi i lartpërmendur mund të ketë një shmangie kur nuk ka të bëjë me pjesë thelbësore të tenderit, si për shembull broshura, anekse ose dokumente të tjera që kanë karakter jo të detyrueshëm, por thjesht dorëzohen nga OE për të përshkruar më mirë produktin e ofruar. Në të kundërt, në rastin e përmendur, OE ka paraqitur në një gjuhë tjetër specifikimet teknike të cilat përfaqësojnë një pjesë thelbësore dhe të nevojshme për pranimin e tenderuesit. Kështu, duke pasur parasysh konsideratat e lartpërmendura, tenderi i cili ofron specifikimet teknike në gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar me LPP, duhet të përjashtohet. Ndërsa për cilindo dokument tjetër të kërkuar si dëshmi sipas nenit 65-71 të LPP-së, në përputhje me nenin 72 të LPP-së mund të kërkohet nga OE që të dorëzojë një përkthim zyrtar të të njëjtit dokument".*

Prandaj duke u bazuar në nenin 13 par. 4 të LPP si dhe opinionin nr. 7 të KRPP të dt. 22.11.2022 lidhur me këtë dispozitë ligjore, si dhe duke marrë parasysh dokumentet me të cilat ka ofertuar parashtuesi (konkretisht Atestet), është gjetur se edhe ky pretendim i parashtuesit është i pabazuar në tërësi.

**Lidhur me pretendimin e katërt (IV):** në dosjen e tenderit në kuadër të kapacitetit teknik dhe profesional (9.1&9.1 – kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale) është gjetur se kriteri i pestë ka qenë si në vijim:

5. Çertifikaten UNE – EN 1436 të lëshuar nga prodhuesi;	kopja e Çertifikaten UNE – EN 1436 të lëshuar nga prodhuesi;
---	--

Nga administrimi i dokumenteve me të cilat ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar është gjetur se tenderuesi i rekomanduar në emër të këtij kriteri ka dorëzuar dokumente në gjuhën serbe (që është e lejuar sipas nenin 13 par. 4 të LPP). Pra nuk qëndron aspak pretendimi i parashtuesit se tenderuesi i rekomanduar këtë dokument e ka dorëzuar në gjuhën gjermane. Në anën tjetër duke u bazuar edhe në sqarimet e ofruara lidhur me pretendimin e tretë, nuk është fare kontestuese se dokumentet në gjuhën serbe janë të pranueshme sipas dosjes së tenderit dhe LPP në fuqi.

Përndryshe tenderuesi i rekomanduar e ka dorëzuar edhe një dokument në gjuhën gjermane mirëpo ai dokument nuk ka qenë kriter i dosjes së tenderit prandaj është dorëzuar vetëm si dokument shtesë (mbështetës). Ky veprim (dorëzimi i dokumenteve shtesë përtej DT) nuk përbën shkelje ligjore dhe ky fakt nuk është fare konstestues as për vet parashtuesin. Prandaj edhe ky pretendim i parashtuesit është i pabazuar në tërësi.

Duhet pasur parasysh që parashtuesi në këtë aktivitet të prokurimit është eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm. Prandaj në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP, nuk është fare palë e interesuar sa i përket pretendimeve të tij lidhur me tenderuesin e

suksesshëm sipas rekomandimeve të komisionit vlerësues dhe njoftimit mbi vendimin të autoritetit kontraktues.

Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 19.06.2023**



Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.